




**Nr. 229/2026**

**Datë: 14.07.2026**

Duke u bazuar në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës; në Nenin 16, pikën 16.3.3 të Statutit të KMDK-së Sh.A të datës 30.05.2025; në Rregullorën Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm, Pagat, Benefitet dhe shtesat në KMDK Sh.A të datës 29.08.2025; Vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. 33/2025 për miratimin e Përshkrimeve të Vendeve të Punës në KMDK Sh.A. i datës 29.08.2025, dhe neni 5, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2024 për Kriteret dhe Procedurat e Punësimit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A., Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i KMDK-së nxjerr këtë:

#### **VENDIM PËR PLOTËSIM/NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.207/2026**

- Shtyhet afati i aplikimit për pozitën “Ekspert për Projektim dhe Monitorim” për tetë (8) ditë shtesë, deri më datë 24.07.2026.
- I. Obligohet Departamenti për Shërbime Mbështetëse të njoftojë kandidatët e interesuar përmes publikimit të këtij vendimi në ueb faqe dhe platforma të tjera online, në ditën e njëjtë të hyrjes në fuqi të vendimit.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### **Arsyetim**

Mbështetur në Rregulloren Nr. 01/2024 për kriteret dhe procedurat e punësimit në KMDK Sh.A., vazhdohet afati i konkursit publik për pozitën “**Ekspert për Projektim dhe Monitorim**” edhe për tetë (8) ditë shtesë me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv (KE). Ky shtyrje bëhet me qëllim të rritjes së shikueshmërisë (vizibilitetit) përmes publikimit edhe në rrjete sociale, duke garantuar kështu një proces konkurrues dhe transparent për rekrutimin e kandidatëve sa më cilësorë. Duke qenë se ky profil profesional është i domosdoshëm për suksesin, qëndrueshmërinë dhe mbikëqyrjen e investimeve kapitale të kompanisë, shtrirja e afatit siguron përputhshmërinë e plotë me standardet e kërkuara teknike dhe ligjore.

#### **Vendimi u dërgohet:**

Arkivit të KMDK SH.A

Administratës së KMDK SH.A.

Dardan Velija  
Kryeshef Ekzekutiv KMDK SH.A